(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

#### Shtojca 2.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

#### LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

#### Oferta ekonomike e detajuar

Nr.	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total
1.		Sipas Preventivit të punimeve (Shtojca 10)	Komplet	1		
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Vula**

**Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

---

#### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

#### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

**“Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”**

---

### **Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Objekti: “Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”**

*Bashkalidhur sistemit te APP-se do gjendeni specifikimet teknike.*

#### **Shënime:**

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku eshte cituar standard nderkombetar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

#### Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

**Afatet e realizimit të punimeve: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga dorezimi i sheshit të ndertimit.**

**Grafiku i punimeve** do te vendoset ne dispozicion te Operatoreve Ekonomik, bashkëlidhur Dokumentave Standarte të Tenderit.

1 Nr	2 Përshkrimi i Punëve	3. Afati i realizimit				
		Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

---

#### Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast te bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

---

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë :

#### 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: *sipas shtojcës 8,*

##### 1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tre viteve të fundit financiare (2021-2022-2023). Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e fondit limit të procedurës së prokurimit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit financiare 2021, 2022 dhe 2023. *Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, Dega e Tatim Taksave,*

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së për vitin 2023.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga njësite ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023.*

*Pika 2.2.3 konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit plotësojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , sipas shtojcës 8 .*

### 2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

---

#### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme e realizuar për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit.

*Ose*

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera dhe të realizuara, të marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

#### Plotësimi i njërët prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.
- Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
    - Kontratë Sipërmarrje;
    - Situacionin përfundimtar të objektit;
    - Aktin e kolaudimit të objektit;
    - Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Vërtetim për realizimin e punimeve ku të përcaktohet dhe përqindja e pjesëmarrjes së punës së realizuar në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik;
    - Kontrate Sipërmarrje;
    - Situacionin përfundimtar;





## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

- *Fatura tatimore per situacionin perfundimtar.*

- Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit te sipercituar per secilin rast, respektivisht duhet te paraqesë duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve dhe Prokuren e Posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit shoqeruar me tabelen e ndarjes se punimeve qe ka marre përsipër te kryeje secili anëtar e i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Shënim:** Kontrata te ngjashme persa i përket punimeve elektrike për vete specifiken qe kane, do te konsiderohen punimet ne Nënstacione elektrike me nivel tensioni  $\geq 110$  kV.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve te nenit 88, pika 3, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, kushti i përcaktuar më sipër në lidhje me kontratat e ngjashme plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

2.3.2 a. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, ne baze te VKM nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **Kategoria NP- 1** Punime gërmimi ne toke **Klasifikimi B**
- **Kategoria NP- 2** Ndërtime civile dhe industrial **Klasifikimi C**
- **Kategoria NP-5** Punime nëntokësore **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-11** Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e te mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) **Klasifikimi F**
  - **Kategoria NP-12** Punime te Inxhinierisë se mjedisit **Klasifikimi B**
  - **Kategoria NS- 8** Ndërtime parafabrikat beton arme, Struktura metalike dhe druri **Klasifikimi B**
    - **Kategoria NS-12** Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit **Klasifikimi A**
    - **Kategoria NS-13** Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni **Klasifikimi A**
    - **Kategoria NS-14** Impiante te brendshme, elektrik, telef, radiotelefo Tv, **Klasifikimi A**

*Për operatorët e huaj te behet njehsimi i licencës profesionale qe disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës ne plotësimin e licencave profesionale te kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*



## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

### **“ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”**

---

**2.3.3 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje këtë kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqesë certifikatat përkatëse te vlefshme ose ekuivalentet e tyre, te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, si me poshtë:**

- 1.Operatori Ekonomik duhet te paraqesë certifikate ISO 9001 - 2015 “Për menaxhimin e cilësisë”, objekti i se cilës te jete ne përputhje me objektin e prokurimit.**
- 2.Operatori Ekonomik duhet te paraqesë certifikate ISO 14001-2015 “Për menaxhim mjedisi”, objekti i se cilës te jete ne përputhje me objektin e prokurimit.**
- 3.Operatori Ekonomik duhet te paraqesë certifikate OHSAS-45001-2023 “Për sistemin e menaxhimit te shëndetit dhe sigurimit ne pune”, objekti i se cilës te jete ne përputhje me objektin e prokurimit.**
- 4.Operatori Ekonomik duhet te paraqesë Certifikate ISO 50001:2018 “Standart për Menaxhimin e Energjisë”, objekti i se cilës te jete ne përputhje me objektin e prokurimit.**
- 5.Operatori Ekonomik duhet te paraqesë Certifikate ISO 27001:2013 “Standart për sistemin e Menaxhimin e sigurisë se Informacionit”, objekti i se cilës te jete ne përputhje me objektin e prokurimit.**

Certifikatat e mësipërme duhet te jene lëshuar nga një organ i vlerësimit te konformitetit i cili te jete i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshëm e Akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet te jene te vlefshme dhe aktive ne datën e hapjes se ofertave.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorëzojë certifikatat sipas natyrës së punimeve që do të realizojë, të parashikuar në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit.

**2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë për listën e mallrave të mëposhtëm:**

- Transformatori i Fuqisë
- Monitorim izolacioni BMT për transformator fuqie
- Çelësi 110 kV
- Ndarësi 110 kV
- Transformator Rryme 110 kV
- Transformator Tensioni 110 kV
- Panele kontrolli
- Panele mbrojtje
- Çelat TM 40.5 kV dhe 24 kV
- Panele AC/DC dhe Salla Baterie

**1-Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqesë Autorizim te prodhuesit/Distributorit te autorizuar.**



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

---

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

*Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe.*

2-Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi të kryera me pare, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme ose të ngjashme) me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.

*Shënim: Testet duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe.*

3-Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/për listën e materialeve të mësipërme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike baze të përkthyer në gjuhën shqipe.

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listepagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ku të ketë të pasqyruar të paktën 70 punonjës për 3 muajt e fundit duke marrë si reference datën e hapjes së tenderit; të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë të paktën:

- Ing. Elektrik 2 (Dy)
- Ing. Ndërtimi 1 (nje)
- Ing. Mekanik 1(nje)
- Inxhinier Elektronik 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1(nje)

2.3.7 Gjithashtu si pjesë e stafit të tij ofertuesi përveç inxhinierëve të mësipërm në rolin e drejtuesit teknik duhet të ketë staf mbështetës dhe 1(një) inxhinier elektrik dhe 1(një) Inxhinier ndërtimi.

Punonjësit e mësipërm duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë në listepagesat përkatëse E-Sig për 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për inxhinierët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten CV-të, dëshmitë/certifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

---

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet ti ketë ne stafin e tij dhe ne listepagesat e shoqërisë tre muajt e fundit përpara datës se njoftimit te kontratës specialistet e mëposhtëm:**

- 1) 1 (Një) Punonjës të certifikuar për Auditimin e energjisë

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë

- certifikatat e kualifikimit/trajnimit
- listpagesat E-Sig

- 2) 1 (Një) Inxhinier të certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalent për instalimin dhe komisionimin pajisjeve monitoruese BMT (Monitorimi i Izolatorëve të Transformatorit), i cili do të realizoje këtë shërbim.

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontrata e punës
- Liste pagesat.
- Certifikata përkatëse e Inxhinierit te certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalente i pajisjeve monitoruese BMT (Monitorimi i Izolatorëve të Transformatorit), i cili do të realizoje këtë shërbim.

- 3) Operatori ekonomik (ne baze te VKM 312 Dt.05.05.2010 për miratimin e rregullores për sigurinë ne kantier) duhet te ketë te paktën 5 (pesë) punonjës te trajnuar dhe te pajisur me certifikata te punimeve ne lartësi te lëshuara nga shoqëri te licencuara nga ministria përkatëse, te cilët te rezultojnë ne listë pagesat e shoqërisë te paktën për 3 (tre) muajt e fundit duke marre reference datën e hapjes se tenderit.

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- certifikatat e punonjësve për punimet ne lartësi
  - listpagesat E-Sig te punonjësve te sipërcituar.
- 4) Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë te punësuar ne stafin e tij te paktën 3 muaj e fundit përpara datës se njoftimit te kontratës te paktën:

15 (pesë) punonjës të pajisur me Dëshmi kualifikimi te Sigurimit Teknik.

Ku 5 (pese) punonjës të kenë kategorinë, e IV ose më e lartë dhe pjesa tjetër të jenë te pajisur me OMVK për elektrikist.

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- certifikatat e punonjësve
- listpagesat E-Sig te punonjësve te sipërcituar.



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

---

- 5) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3-muajt e fundit, stafi mbështetës si më poshtë:

- 1 Teknik Ndërtimi
- 1 Drejtues për makineri te renda/Manovrator

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Diplomati/Dëshmitë e punonjësve
- listpagesat E-Sig te punonjësve te sipërcituar

- 6) Operatori Ekonomik duhet te ketë te punësuar ose me kontrate shërbimi, mjekun e shoqërisë te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, sipas parashikimeve te VKM-se Nr.692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742 date 06.11.2003.

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet te plotësojë këtë kërkesë duke pasur ne konsiderate edhe parashikimin e pikës 3 të nenit 88 te VKM-se Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar).

- 7) Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 1(nje) Inxhinier elektrik te certifikuar per: arkitekturen dhe skemat e Nenstacioneve elektrike te TL; mbrojtje dhe komandime; Scada/RTU dhe rele, te cilet duhet te jene te siguruar jo me pak se 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontratës

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Diplomati/Dëshmitë e punonjësve
- listpagesat E-Sig te punonjësve te sipërcituar

- 8) Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 1(nje) punonjës te certifikuar si “ Ekspert per Ndhimen e Pare dhe Nderhyrjen ndaj energjencave” i cili duhet te jete i siguruar jo me pak se 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontratës

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Diplomati/Dëshmitë/Certifikatat e Trajnimit
- listpagesat E-Sig te punonjësve te sipërcituar

- 9) Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë minimumi 1(një) punonjës “ Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve ne mjedis” i cili duhet te jete i siguruar jo me pak se 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontratës

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Diplomati/Dëshmitë/Certifikatat e Trajnimit
- listpagesat E-Sig te punonjësve te sipërcituar

- 10) Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë minimumi 1(një) punonjës “ Ekspert Zjarrfikës”



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

i cili duhet te jete i siguruar jo me pak se 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontratës

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Diplomati/Dëshmitë/Certifikatat e Trajnimit
- listpagesat E-Sig te punonjësve te sipërcituar
- 11) Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë minimumi 1(një) punonjës “ Përgjegjës për Sigurinë dhe Kontrollin e Cilësisë” i cili duhet te jete i siguruar jo me pak se 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontratës

Lidhur me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Diplomati/Dëshmitë/Certifikatat e Trajnimit
- listpagesat E-Sig te punonjësve te sipërcituar

*Për pikat si më sipër 2.3.8 (nga 1 tek 11) operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër*

**Shënim:** Për plotësimin e pikës 2.3.8 me sipër (nga 1 tek 11) i njëjti specialist mund te paraqitet për plotësimin e dy ose me shume kriterëve kualifikuese.

**Shënim:** Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku konkretisht në pikën 6, të nenit 26, parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...

*Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6, të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.*

**9.Operatori Ekonomik duhet te përcaktojë me ane te një deklarate nga Administratori i Shoqërisë, drejtuesin teknik te punimeve ne objekt i cili duhet te jete Inxhinier Elektrik. Drejtuesi teknik i punimeve duhet te jete i përfshirë ne licencën e shoqërisë , te ketë kontrate pune te vlefshme dhe te mos jete i angazhuar ne kontrata te tjera.**

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetë- deklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

#### 2.3.1 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme; të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i mjetit	Sasia
1.	Makineri auto vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	2 copë
2.	Auto kulle per punime ne lartësi $h > 7$ m	1 copë
3.	Vinc jo me te vogel se 150 ton	1 copë
4.	Kamion me kapacitet mbajtes 5 - 7 ton	2 copë
6.	Fadrome	1 copë
7	Ekskavator me Goma	1 cope
8.	Ekskavator me Zinxhire	1 Cope
9.	Miniekskavator me zinxhir gome	1 Cope
10.	Minifadrome	1 Cope
11.	Pick Up per transport stafi teknik dhe materialesh ne kantier	1 Cope
12.	Kamioncina	2 Cope
13.	Rrul Ngjeshes	1 Cope
14.	Autobetoniere	1 Cope
15.	Autopompe Betoni	1 Cope
16	Kamion me Vinc	2 Cope
17.	Zyre te levishme	1 Cope
18.	Rimorkiator per transportin e makinerive te renda	1 Cope
19.	Depozite uji 5000 lt	2 Cope
20.	Elektrosaldatrice	1 cope
21.	Gjenerator	1 Cope
22.	Impiant prodhim betoni te pajisur me leje mjedisore jo me larg se 50 km nga objekti	1 Cope

Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikate pronësie), dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); të vlefshme. Për mjetet e siguruar me qera, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë regjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit të vlefshme. Këto dokumente duhet



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

te shoqërohen me kontratën e lidhur para noterit për këtë objekt për te gjithë periudhën e realizimit te kontratës objekt i ketij prokurimi. Për mjetet e tjera qe nuk janë te shënuara ne regjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes / fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit.

1. Për pajisjet ne pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.
2. Për pajisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit për ketë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.
3. Impianti i prodhimit te betonit nëse nuk është ne pronësi te operatorit ekonomik ofertues mund te paraqitet kontrata e qerese ose kontrata e furnizimit.
4. Operatori Ekonomik nuk duhet t`i ketë mjetet dhe pajisjet teknike te angazhuara ne kontrata te tjera dhe nuk duhet te jene te deklaruar ne procedura te shpallura fituese (deklarate me shkrim nga administratori i shoqërisë sipas Shtojcës Nr.8 te kesaj DST).

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

Reflektim: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

**2.3.3 Afati i kryerjes se punimeve është: 18 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.**

Operatori Ekonomik duhet te paraqese grafikun e punimeve ne perputhje me afatin kohor qe eshte lene ne dispozicion per realizimin e kontrates.

**SHENIM: Kudo që është përdorur fjala “importi” zëvendësohet “importi ose ekuivalent”.**

*Afati i realizimit të objektit të kontratës, u caktua ;*

*Realizim brenda një periudhe 18 muaj nga dorezimi i sheshit te ndertimit, u mendua se është i realizueshëm për volumin e punëve që përmban projekti.*

*Të gjitha kërkesat dhe shtojcat e tjera u hartuan në përputhje me dokumentet standarte.*

*Vendosja e te gjithë ketyre kritereve e siguron Autoritetin Kontraktor se ofertuesi ka kapacitetet teknike te nevojshme per realizimin e kontrates.*

*Dokumentet e paraqitura në gjuhë të tjera nga shqipja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe;*





## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

*Garancia e punimeve, në vlerën prej 5% të preventivit, do të rikthehet operatorit ekonomik fitues 1 vit pas kolaudit të punimeve.*

*Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961;*

*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara;*

*Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

## Shtojca 8

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

#### Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

#### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## B: DEKLARATA

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

- a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “ Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

**Deklarata**



## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

### “Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit Kafaraj 110/35/6 kV”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
